



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:153609
Datë: 19.09.2024
Numri i dokumentit: 06180698

Ac.nr.8584/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Besnik Feka, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.B. nga Gjilani, kundër të paditurës “A.A.E.” Sh.p.k. me seli në Gjilan, sipas kontestit për pengim posedimi, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga paditësi, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, C.nr.84/2018, të datës 20.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 18.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet e themeltë ankesa e paditësit A.B. nga Gjilani, anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, C.nr.84/2018, të datës 20.10.2023, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin ankimor C.nr.84/2018, të datës 20.10.2023, në pikën I të dispozitivit ka vërtetuar se padia C.nr.84/2018 e parashtruar me datë 25.05.2018 pranë Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, nga ana e paditësit A.B. nga Gjilani, është e tërhequr. Në pikën II të dispozitivit secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit të paraparë ligjor ankesë ka parashtruar paditësi, për shkak shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi ankesën e paditësit ashtu që të anulohet aktvendimi i atakuar dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe çështja të vazhdohet aty ku ka mbetur para nxjerrjes së aktvendimit ankimor.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

- Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësi ka parashtruar padi pranë gjykatës së shkallës së parë me datë 25.05.2018, kundër të paditurës “A.A.E.” Sh.p.k. me seli në Gjilan, për pengim posedimi dhe kompensimin e dëmit.

Gjykata e shkallës së parë ka caktuar shqyrtimin për datën 05.10.2023, me fillim në ora 11:00, dhe ka ftuar paditësin, mirëpo nuk ka prezantuar në seancë përkundër se ftesa është tentuar që ti bëhet me datë 29.08.2023, përderisa ai nuk ka qenë në shtëpi, ndërsa anëtarët e familjes kanë refuzuar pa ndonjë arsye që ta pranojnë ftesën, për këtë arsye gjykata ka marrë aktvendimin C.nr. 84/2018 të datës 20.10.2023, me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit.

Kundër këtij aktvendimi paditësi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj si të bazuar ankesën ndërsa të anuloj aktvendimin e atakuar dhe çështja të kthehet në rigjykim në shkallë të parë dhe të vazhdohet procedura aty ku ka mbetur para nxjerrjes së aktvendimit të ankimuar.

Po ashtu paditësi në afatin ligjor ka ushtruar edhe propozim për kthim në gjendjen e mëparshme, për shkak se gjykata e shkallës së parë nuk ka respektuar në mënyrë të duhur dispozitat nga nenet 110,111 dhe 112 të LPK-së, me rastin e tentim dorëzimit të ftesës për seancën e datës 05.10.2023, me propozim që të aprovohet propozimi dhe të lejohet kthimi në gjendjen e mëparshme, ashtu që paditësi t’ dorëzohet ftesa në mënyrë të rregullt për seancë gjyqësore.

Gjykata me aktvendimin C.nr.84/18 të dt.15.03.2024 e refuzon si të pabazuar propozimin dhe nuk e lejon kthimin në gjendjen e mëparshme për shkak të lëshimit të seancës së datës 05.10.2023.

Gjykata e Apelit, vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1, lidhur me nenet 110, 111 dhe 112, të LPK-së.

Kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 të LPK-së, me aplikim të dispozitës së nenit 409 par.1, të LPK-së. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si në aktvendimin e atakuar gabimisht i është referuar dispozitës së nenit 409 par.1, të LPK-së, që ka të bëjnë me prezencën e paditësit në

seancën përgatitore dhe rregullsinë e thirrjes së tij për seancë, në kuptim të nenit 110, paragrafi 1 të LPK-së, ku përcaktohet se: “ *Padia, përgjigjja në padi, letërthirrja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankim i veçantë, mjete i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj. Shkresat e tjera do t’i dorëzohen personalisht adresatit kur një gjë e këtillë shprehimisht parashihet me këtë ligj apo kur gjykata konkludon se për shkak të dokumenteve origjinale që i janë bashkangjitur shkresës që duhet dorëzuar, ose nga ndonjë shkak tjetër, nevojitet kujdes i shtuar* ”. Andaj në rastin konkret gjykata nuk ka mundur që ta konsideron dorëzim të rregullt ftesën për seancën e datës 05.10.2023, sipas konstatimit të familjarëve të tij në fletë kthesë, se: *familjarët refuzojnë pranimin e ftesës*, pasi që ky dorëzim nuk konsiderohet i rregullt sipas dispozitës së nenit 111 të LPK-së, lidhur me dispozitën e nenit 112 të LPK-së, ku qartë është e përcaktuar se: “ *Kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtari i rritur i familjes së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuar në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, dorëzuesi do t’ia lejë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi i tillë apo do t’ia bashkëngjis shkresën në derën e banesës apo lokalit të punës* ”. Për këtë arsye gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vendosur si në aktvendimin e ankimuar, për shkak se sipas dispozitës së larët cekur është e përcaktuar se kur anëtarët e familjes pa ndonjë arsye refuzojnë pranimin e shkresës, dorëzuesi është i obliguar që shkresën e tillë t’ia bashkëngjisë në derën e banesës apo shtëpisë ku banon paditësi, ndërsa në fletë dërgese do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa, komunikimi i kryer në këtë mënyrë quhet i ligjshëm. Andaj, nga këto arsye është dashur që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja ti kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

Në ri procedurë gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara me lartë, të veproj sipas dispozitave të lartë cituara, duke ndërmarrë veprimet e duhura, e pastaj të vazhdoj procedurën konform dispozitave ligjore sipas bazës së kërkesëpadisë së paditësit që është pengim posedimi e cila është procedurë e posaçme e rregulluar me dispozita të posaçme të LPK-së, ashtu që ta ftoj paditësin që ta bëjë rregullimin e padisë së tij, se a bëhet fjalë për pengim posedimi apo për kompensim dëmi, si dhe të përcaktohet saktë legjitimitetin real pasiv i të paditurës, pastaj të caktoj seancën përgatitore, të ftoj palët në mënyrë të rregullt, dhe të vazhdoj procedurën konform dispozitave ligjore duke marr aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8111/2022, më datë 18.09.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.